



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 801/3 Prot.

Vlorë më 28.02.2025

**VENDIM**

Nr. 13, datë 28.02.2025

**PËR  
KRITERET DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË  
ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në zbatim të neneve 49 pika 1, gërma "f" dhe neni 51 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neneve 25 pika 1, gërma "f" dhe 40 pika 2, të Statutit të UV-së, në mbledhjen e datës 28/02/2025, Bordi i Administrimit:

**VENDOSI:**

**I. Të miratojë si kritere për punësimin e Administratorit të UV-së si më poshtë:**

**I/a Kriteret e veçanta**

1. Të zotërojë një diplomë të arsimit të lartë, minimalisht në nivelin "Master i Shkencave", në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku 7 (shtatë) vjet në këto fusha. Preferohet të ketë përvojë pune në Institucionet e Arsimit të Lartë ose në fushën e administrimit publik apo financiar ose mësimdhënies;
2. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja të një vendi të BE. Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhës së huaj anglisht;
3. Të ketë mesatare notën 9 (nëntë) në studimet e larta.
4. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj, sipas testeve ndërkombëtare;

**I/b Kriteret e përgjithshme**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Të mos jetë i dënuar me parë me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

5. Të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga administrata shtetërore, e cila nuk është shuar sipas ligjit;
6. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;
7. Të ketë aftësi të mira komunikimi, bashkëpunimi dhe menaxhimi për të zgjidhur çështjet me efikasitet.

**II. Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën:**

1. Fotokopje të kartës së identitetit;
2. Një kopje të jeteshkrimit (CV);
3. Kopje të noterizuara të diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MASR (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për të dy ciklet e studimit);
4. Kopje të librezës së punës;
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
6. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
7. Vërtetim nga punëdhënësi të mëparshëm, që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
8. Çertifikatë të kualifikimeve dhe trajnimeve;
9. Dëshmi të njohurive të programeve bazë kompjuterike;
10. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë.

**III. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën:**

Adresa: Universiteti "Ismail Qemali", Rektorati,  
Lagja "Pavarësia", Rruga "Kosova", 9400 Vlorë, Shqipëri.

1. Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.
2. Ngarkohet Sektori i IT – së të bëjë shpalljen në faqen zyrtare në internet të UV – së.
3. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arkivës për ndjekjen e afateve sipas legjisllacionit në fuqi, për konkurim të hapur për pozicionin e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Çdo vendim i mëparshëm në lidhje me kriteret e punësimit të Administratorit të UV-së shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

SOTIR NIKOLLA

